

VENDIM
Nr.213, datë 12.4.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË 15 000 M² SIPËRFAQE TRUALLI DHE TË OBJEKTEVE TË REZERVAVE TË SHETIT “AGJENCIA KAVAJË”,
NGA MINISTRIA E BRENDSHME MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË KAVAJËS TË 49 844 M² SIPËRFAQE TRUALLI DHE TË OBJEKTEVE TË KËSAJ AGJENCIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10 e 11 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, si dhe të neneve 3, 5, e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të 15 000 m² sipërfaqe trualli dhe të disa objekteve të rezervave të shtetit “Agjencia Kavajë”, nga Ministria e Brendshme Ministrisë së Shëndetësisë. Prona kufizohet: në jug nga rruga qytet-autostradë, në lindje nga ish-SMT-ja, në perëndim nga autostrada dhe në veri nga pjesa që i transferohet në pronësi bashkisë së Kavajës.

2. Transferimin e një sipërfaqeje 49 844 m² truall dhe të objekteve të rezervave të shtetit “Agjencia Kavajë”, në pronësi të bashkisë së Kavajës, por kësaj bashkie nuk i transferohet “Magazina (depo) nr.7”, e cila ka kaluar në përgjegjësi administrimi të prefektit të qarkut të Tiranës, me vendimin nr.773, datë 19.11.2004 të Këshilli të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Shëndetësisë, kryetari i bashkisë së Kavajës dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha